

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2024/2025, DERI MË 17.04.2025

Hyrje

Kolla e mirë ose pertusis është një infeksion respirator shumë ngjitës i shkaktuar nga bakteri *Bordetella pertussis*, i lidhur me fëmijërinë e hershme. Sëmundja karakterizohet nga një kollë tipike në formën e sulmeve paroksizmale, të cilat shpesh mund të shkaktojnë hipoksi. Edhe pse mund të shkaktojë sëmundje serioze te njerëzit e të gjitha moshave, pertusis mbetet një nga shkaqet e rëndësishëm të morbiditetit dhe mortalitetit tek fëmijët nën 2 vjet.

Sipas të dhënave të OBSH-së, në vendet në zhvillim ka një ngarkesë të lartë nga pertusis. Pavarësisht mbulimit të lartë me vaksinim, pertusis vazhdon të jetë një problem i rëndësishëm i shëndetit publik, për shkak të morbiditetit dhe mortalitetit së lartë tek foshnjat. Shkalla e mortalitetit tek foshnjat në vendet në zhvillim është rreth 4%. Mbulimi i lartë me imunizim me një vaksinë efektive është baza për parandalimin e kësaj sëmundjeje.

Historia

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut vakcina kundër pertusis u prezantua si vaksinë e detyrueshme në vitin 1960. Në periudhën pesëvjeçare (1955-1959) para prezantimit të kësaj vaksine numri i përgjithshëm i të infektuarve me pertusis ishte 17.665, 100 prej të cilëve ndërruan jetë. Pas prezantimit së vaksinimit numri i të sëmurëve/të vdekurve ka shënuar një rënie të ndjeshme dhe të vazhdueshme. Rasti i fundit i vdekjes është regjistruar në vitin 2001.

Në dhjetë vitet e fundit (2014-2023) janë regjistruar vetëm raste sporadike dhe numri më i madh i rasteve është regjistruar në vitin 2018, gjithsej 32 persona. Në vitin 2021-2022 nuk janë raportuar raste të pertusis, ndërsa në vitin 2023 janë raportuar 4 raste, të gjitha në Shkup (nga një në shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor).

Mbulimi mesatar me vaksinim primar, me tre doza të vaksinës DTP që përmban komponentin kundër pertusis, në RMV në periudhën 2013-2022 është 90.3%, por me një tendencë të rënies, që është theksuar veçanërisht në tre vitet e fundit gjatë pandemisë së COVID-19, kur u regjistrua mbulim nën 90%. Në vitin 2023, mbulimi me vaksinim primar me tre doza të vaksinës DTP është 86,3%.

Të dhëna kumulative

Deri me datë 17.04.2025, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 1.188 raste me pertusis, me një incidencë prej 64,7/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 834 (70,2%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 1).

Gjatë vitit 2024 në vend u raportuan tre epidemi të pertusis, Shkup (n=834; 70,2%), Kumanovë (n=108; 10,8%) dhe Tetovë (n=66; 55,6%). Pas përfundimit të periudhës së dyfishtë të inkubacionit nga rasti i fundit, epidemitë në Shkup (07.04.2025), Kumanovë (14.01.2025) dhe Tetovë (22.11.2024) u shpallën të përfunduara nga QShP-të përkatëse. Rastet e tjera të regjistruara janë sporadike dhe nuk janë të lidhura me raste nga epidemitë e raportuara.

Raste janë raportuar edhe në 20 qytete të tjera në të gjithë vendin.

Incidencë më e lartë prej 265,1/100.000 banorë është regjistruar në Kratovë, në Shkup (137,4/100.000) dhe në Kumanovë (103,3/100.000). (Hartogrami)

Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QShP/NJR, pertusis në RMV, 2024




Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 2024-2025

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë	Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	834	Manastir	51
Aerodrom	163	Manastir	50
Karposh	131	Mogilla	1
Çair	110	Prilep	20
Kisella Voda	87	Prilep	12
Qendër	71	Dollnen	7
Gazi Baba	50	Krivogashtan	1
Studenica	43	Kratovë	20


Gjorçe Petrov	43	Kriva Pallankë	15
Butel	40	Gostivar	8
Saraj	32	Gostivar	7
Shuto Orizare	21	Vrapçisht	1
Haraçina	16	Kërçovë	7
Petrovec	9	Probishtip	7
Sopishte	5	Strumicë	5
Çußer Sandevë	5	Strumicë	4
Ilinden	6	Bosilovë	1
Zelenikovë	2	Veles	4
Kumanovë	128	Gjevgjeli	4
Kumanovë	108	Koçan	3
Likovë	20	Dibër	3
Tetovë	66	Strugë	2
Tetovë	28	Krushevë	2
Zhelinë	15	Kavadar	2
Tearcë	13	Prespë	2
Bogovinjë	4	Negotinë	2
Brvenicë	4	Ohër	1
Jegunovc	2	Demir Hisar	1
		Makedonski Brod	1
		Pllasnicë	1

Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 82 vjet (mediana 8,7 vjet, IQR 25-75%=1-16 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë në moshë deri në 4 vjet , 261 ose 22,0% janë në moshë nën 1 vjet, pastaj vijnë ata nga 1 deri në 4 vjet (n=75, 25,8%), (15,3%) janë nën 1 vjet, (10,4%) ose 51 janë nga 1 deri në 4 vjet me 177 (14,9%).

Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (I=1.578,5/100.000). (Grafiku 1).

Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 543 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 645 femra, raporti mes tyre është 1:1,2.

Grafiku 1. Shpërndarja e të sëmurëve me pertusis (n=1.188) sipas moshës, në RMV, 2024/2025




Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve (1.188), tek 1.179 persona janë regjistruar simptoma, ndërsa 9 e kanë kaluar sëmundjen në formë asimptomatike.

Janë hospitalizuar 196 persona (16,5%) dhe atë 172 (87,8%) prej tyre në moshë nën 4 vjet.

Lakorja epidemike tregon se shfaqja e simptomave të rastit parë i regjistruar i regjistruar në epideminë në Shkup ka filluar në javën e 50 të vitit 2023. Sipas të dhënave të anketimit epidemiologjik, sa i përket datës së fillimit të simptomave të para, tek personat e sëmurë nga java e parë e vitit 2024 vihet re një rritje e vazhdueshme e rasteve në nivel javor, deri në javën e 11. Nga java 12-25 numri i rasteve shënon fluktuacione, ndërsa nga java e 26 vihet re një tendencë e rënies së numrit të rasteve të reja. Rasti i fundit i raportuar ka manifestuar simptoma në javën e 8 të vitit 2025.


Grafiku 2. Shpërndarja e të sëmurëve me pertusis (n=1.188) sipas javës së manifestimit të simptomave në RMV, 2024/2025



Sa i përket statusit të vaksinimit, 63,2% (n=751) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 437 (36,8%) persona. (Grafiku 3).

Grafiku 3. Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=1.188) me vaksinë kundër pertusis në RMV, 2024/2025



Nga numri i përgjithshëm (n=1.188) i rasteve të regjistruara me pertusis, **në laborator janë vërtetuar** 1.185 dhe atë në Avicena (305), ISHP (229), Biotek (182), QShP Kumanovë (136), Sinlab (79), Laor (55), Instituti i Mikrobiologjisë (46), SK Sistina (41), QShP Manastir (39),

Pllodnost (28), Klinika Zhan Mitrev (25), SK Manastir (7), Ramus (5), Remedika (5), SP Prilep (2) dhe Ramus Strumicë (1).

Klasifikimi i rasteve:

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=1.188) të kollës së keqe, 1.185 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe tre si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator). Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 181 rastesh.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.

Si pasojë e epidemisë së pertusis, janë zhvilluar aktivitete të intensifikuara për kërkimin e fëmijëve të pavaksinuar dhe të atyre që nuk i kanë pranuar të gjitha dozat e vaksinës dhe vaksinimin e tyre me vaksina që përmbajnë një komponent kundër pertusis. Kjo pati si rezultat rritjen e aktiviteteve të vaksinimit për fëmijët dhe çoi në një rritje të mbulimit me vaksinimin primar me tre doza dhe rivaksinimin e parë dhe të dytë me DTP. Në vitin 2023, mbulimi me tre doza të vaksinës primare DTP ishte 86,3%, me rivaksinimin e parë 71,8%, ndërsa me rivaksinimin e dytë të fëmijëve të moshave shkollare u arrit një mbulim prej 83,1%. Si rezultat i vaksinimit të zgjeruar në vitin 2024 u rrit mbulimi me vaksina që përmbajnë komponentë kundër pertusis dhe vaksinimi primar me vaksinën DTP arriti në 88,3%.


Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01.2024-23.01.2025

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit nga Gazi Baba dhe Çairi, Karposh, Kisella Voda dhe Qendra, është konstatuar se janë zbuluar 23.913 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar **19.154** (80,1%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (8.938; 46,7%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar **26.951** fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (18.245; 67,7%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollare.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01.2024-23.01.2025 është **46.105**.

Grafiku 3. Numri i dozave të administruara të vaksinave në Shkup, 2024-2025




Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01.2024-23.01.2025

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 10.692 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve **8.444 (79,0%)** janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (3.793; 44,9%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar **42.080** fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (24.418; 58,0%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01.2024-23.01.2025 është **50.524**.

Grafiku 4. Numri i dozave të administruara në qytetet e tjera në RMV, 2024-2025



Përfundime

- Mbulimi mesatar me vaksinim primar, me tre doza të vaksinës DTP që përmban komponentin për pertusis, ka shënuar rënie në 10 vitet e fundit para epidemisë. Në vitin 2023, mbulimi me vaksinim primar me tre doza të vaksinës DTP ishte 86,3%.
- Deri më 15.04.2025 janë regjistruar 1.188 të sëmurë me pertusis.

- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (70,5%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 22 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive janë regjistruar në territorin e Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës.
- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 0-4 vjet (36,9%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 1.578,5/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (1.188), 63.2% nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=303), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 11 vjet.
- Nga 1.188 rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 1.185 raste.
- Lidhshmëri epidemiologjike është vërtetuar mes 181 të sëmurëve.
- Nga 18.01.2024-23.01.2025, janë dhënë gjithsej 96.629 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.
- Si rezultat i rritjes së aktiviteteve të zbatuara për vaksinimin e fëmijëve që nuk i janë nënshtruar vaksinimit të rregullt, mbulimi për vitin 2024 me vaksinim primar me tre doza të vaksinës DTP është 88,3%, me rivaksinimin e parë është 82,4% dhe me rivaksinimin e dytë është 87,9%.

Masat e ndërmarra

- Të gjitha rastet e konfirmuara janë raportuar dhe hetuar epidemiologjikisht nga shërbimet kompetente epidemiologjike dhe në ISHP RMV është dorëzuar Raport për Sëmundjet Infektive, si dhe anketë epidemiologjike.
- Për personat e sëmurë, por që nuk janë shtruar në spital, është rekomanduar izolimi shtëpiak.
- Është kryer hetimi i kontakteve të personave të infektuar dhe është rekomanduar profilaksi me antibiotikë.
- Është bërë kontrolli i vazhdueshëm i mbulimit me vaksinim në kopshte, shkolla dhe pika vaksinimi.
- Komisioni i Sëmundjeve Infektive, në mbledhjen e mbajtur më 07.02.2024 rekomandoi masa për kontrollin dhe parandalimin e pertusis.
- Ministria e Shëndetësisë ndaloi pranimin në institucionet parashkollore të fëmijëve të pavaksinuar ose të pavaksinuar plotësisht sipas Kalendarit të Imunizimit.
- Instituti i Shëndetit Publik i RMV ka përgatitur një Udhëzues Profesional dhe Metodologjik për veprim gjatë shfaqjes së epidemisë së pertusis.
- Në ueb faqen e ISHP RMV www.iph.mk është postuar material informativ dhe edukativ për pertusis dhe parandalimin e saj. Përveç kësaj publikohet edhe informacion javor për gjendjen aktuale me pertusis në vend.

Vlerësimi i rrezikut:

Kjo sëmundje në RMV është regjistruar raste sporadike në 20 vitet e fundit (mesatarisht 6).

Rritja e numrit të fëmijëve të pavaksinuar (rënia e mbulimit me imunizimin e detyrueshëm), fushatat kundër vaksinimit dhe hezitimi i prindërve në lidhje me imunizimin po rezultojnë në rishfaqjen e sëmundjeve të parandalueshme me vaksinë.

Duke e pasur parasysh këtë, ekziston mundësia e raportimit të mëtutjeshëm të rasteve të reja sporadike në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ekziston një rrezik mesatar për popullatën në rajonet me mbulim të ulët me vaksinim, por ai mund të minimizohet duke iu përmbajtur rekomandimeve të institucioneve kompetente.

Rekomandime

Për ta parandaluar shfaqjen e rasteve të reja të pertusis dhe për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes, është e nevojshme që:

- Të rritet mbulimi me vaksinim primar me një vaksinë që e përmban komponentin e pertusis për të arritur mbulimin e rekomanduar nga OBSH-ja prej 95%, si në nivel rajonal dhe lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar.
- Për këtë qëllim në të gjitha pikat e vaksinimit në territorin e RMV-së është e nevojshme të kryhen kontrole të zgjeruara dhe të vazhdueshme të personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt dhe të bëhet thirrja e tyre për aplikimin e dozave të nevojshme të vaksinës. Gjithashtu, nevojitet një hulumtim aktiv i intensifikuar për personat e paregjistruar, të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht, me qëllim thirrjen dhe vaksinimin e tyre sipas kalendarit kombëtar të imunizimit.
- Shërbimet epidemiologjike pranë QShP/NjR, në bashkëpunim me IShSSH, duhet të kryejnë kontroll të shtuar në pikat e vaksinimit, të kontrollojnë statusin e vaksinimit të personave që i nënshtrohen vaksinimit dhe të identifikojnë personat e pavaksinuar dhe të pavaksinuar.
- Të forcohet mbikëqyrja epidemiologjike e pertusis. Çdo rast i dyshuar që i plotëson kriteret klinike të përkufizimit të rastit duhet të hetohet epidemiologjikisht, të testohet në laborator, pra të konfirmohet dhe të raportohet pranë institucioneve kompetente.
- Personat e dyshuar/të sëmurë të dërgohen për diagnostikim laboratorik dhe menjëherë të raportohen në institucionet kompetente.
- Të gjithë mjekët amë duhet ta kontrollojnë statusin e vaksinimit të të gjithë fëmijëve deri në 14 vjet gjatë ekzaminimeve dhe t'i udhëzojnë të gjithë fëmijët e pavaksinuar për vaksinim.
- QShP-të dhe ISHP duhet të zhvillojnë aktivitete edukative dhe promovuese në lidhje me parandalimin e pertusis, duke e theksuar vaksinimin si masën e vetme parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik i RMV-së